

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH,
NË PREZANTIMIN E MANUALIT “BARAZIA DHE DIVERSITETI”**

5 prill 2013

Drejtor i Përgjithshëm, Burgaj,
Zonja dhe Zotërinj,

Duke ju drejtuar në cilësinë e Kryetarit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, më lejoni të deklaroj, së pari, që jam shumë lumtur që ndodhem këtu me ju sot.

Botimi i manualit për Barazinë dhe Diversitetin për Oficerët e Policisë Shqiptare është një kontribut shumë i rëndësishëm dhe mund të konsiderohet si një gur themeli në përpjekjet e përgjithshme për ndërtimin e respektit për diversitetin nga ana e oficerëve të Policisë së Shtetit Shqiptar.

Ky manual është rezultati i bashkëpunimit të shkëlqyer midis Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, që përfshin disa fusha të punës së përbashkët në shërbim të sigurisë në vend.

Këto nuk janë thjesht nisma apo veprimtari të veçuara, por një angazhim i qëndrueshëm për trajtimin e diversitetit si një çështje me përparësi për Policinë e Shtetit Shqiptar.

Manuali është vazhdimi i një seminari të suksesshëm për “Diversitetin Strategjik”, të mbajtur në qershor, për drejtuesit e lartë të policisë dhe “Trajnimin e Trajnuesve mbi Barazinë dhe Diversitetin”, për Instruktorët dhe Trajnuesit e Policisë të mbajtur në tetor të vitit të kaluar.

Rëndësia që ka respekti dhe mbrojtja e diversitetit theksohet nga fakti që të 57-a Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, nga Vankuveri në Vladivostok, vende dhe kultura shumë të ndryshme, kanë ndërmarrë angazhime kërkuese në këtë fushë.

Gjithashtu, disa konventa ndërkombëtare, pjesë e të cilave është Shqipëria, e mbështesin këtë parim si një normë.

Më tej, kjo është një vlerë që na lidh së bashku si individë të respektuar në mënyrë të ndërsjellë në shoqëritë tona.

Në thelb, respekt për diversitetin do të thotë të pranohet veçantinë dhe rëndësinë e secilit individ, pavarësisht nga raca, ngjyra, besimi, etnia, gjinia, mendimi politik, orientimi seksual, apo ndonjë bazë tjetër.

Në fund të fundit, kjo është çështje e të drejtave të njeriut, shtetit ligjor dhe mbrojtjes së barabartë të të gjithë njerëzve.

Kjo nuk ka të bëjë thjesht me pranimin në mënyrë pasive të dallimeve.

Më shumë se kaq: kjo kërkon një kuadër të fortë kushtetues dhe institucional që mundëson që këto dallime të kontribuojnë aktivisht në të mirën e përgjithshme të shoqërive tona demokratike.

Për ta vënë plotësisht në zbatim, ajo duhet të ecë krah për krah një politike me tolerancë zero ndaj çdo lloj diskriminimi.

Këto janë parime themelore e vërtet domethënëse kur bëhet fjalë për policinë – institucioni i krijuar në shërbim të popullit dhe për mbrojtjen e popullit.

Prandaj policia duhet të përdorë të gjithë autoritetin ligjor për të luftuar veprat e motivuara nga racizmi, ksenofobia apo mungesa e tolerancës kundrejt minoriteteve apo grupeve të tjera të cenueshme, sidomos komunitetit rom dhe komunitetit LGBT. Këto vepra janë të papranueshme, një burim shqetësimesh dhe pasigurie shoqërore.

Prandaj, të udhëheqësh përmes dhënies së shembullit është kyçe. Siguri do të thotë që çdo individ duhet të ndihet i mbrojtur dhe i trajtuar me drejtësi kur ndërvepron me oficerët e policisë. Sjellja diskriminuese nga vetë policia nuk mund të tolerohet dhe, si rezultat, duhet dënuar.

Përndryshe kohezioni dhe stabiliteti shoqëror do të vuajnë pasojat, ashtu siç do t'i vuajnë edhe legjitimiteti dhe autoriteti i policisë.

Parë kështu, Manuali mund të përdoret si material didaktik për rekrutët e rinj të Policisë së Shtetit Shqiptar, për të kontribuar që ata të kuptojnë rëndësinë që ka respekti për diversitetin, ta bëjnë atë pjesë përbërëse të punës së përditshme të tyre. Ai mund të përdoret gjithashtu edhe si një mjet orientimi për oficerët e tjerë të policisë, përfshirë ata në nivel strategjik.

Këto përpjekje gjithëpërfshirëse duhet ta ndihmojnë policinë shqiptare që të garantojë respektin për diversitetin gjatë punës së saj të përditshme, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare.

Sipas mendimit tonë, në aspektin praktik, një hap i mëtejshëm në drejtim të mbështetjes ndaj diversitetit brenda vetë policisë, do të ishte integrimi më i mirë i minoriteteve në radhët e saj, në të gjithë nivelet. Kjo do të ishte një masë e mirë për krijimin e besimit dhe themelore për punën në një ambient të respektueshëm.

Gjithashtu, duhet të nxitet përfshirja e grave, si një shembull praktik për zbatimin e angazhimeve lidhur me barazinë gjinore.

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,
Zonja dhe Zotërinj,

Do të doja të ftoja instruktorët e Qendrës së Formimit Policor që të fillojnë ta përdorin këtë manual si një mjet për trajnimin e oficerëve të rinj të policisë, dhe oficerët e lartë të policisë që të integrojnë nocionet e respektit për diversitetin brenda menaxhimit strategjik të policisë.

Mbështetja e diversitetit është një vlerë e përbashkët. Ajo përfaqëson gjithashtu një investim të vlefshëm për të ardhmen e këtij vendi.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet e gatshme që t'ju mbështesë më tej në përmbushjen e këtyre objektivave. Ju faleminderit!